

Këshilla të përshtatshme për kampim dhe pjekje të mishrave në skarë



Verë, diell, kampim dhe pjekje mishrash. Një zjarr kampimi gjatë natës, ose një shtresë qymyri për të pjekur. Por, nëse zjarri del jashtë kontrollit, atëherë bëhet i rrezikshëm. Si mund ta shmangni një gjë të tillë?

Jeta në natyrë

Ata që pëlqejnë jetën në natyrë, u pëlqen gjithashtu të ndezin një zjarr në vend të hapur, ndërsa të tjerët mund të preferojnë të marrin me vete një sobë në natyrë, me një xham erëprités, për ta përdorur nëse keqësohet moti. Më poshtë do të gjeni disa këshilla, se si t'i parandaloni zjarret, kur jeni jashtë në natyrë nëpër fshatra.

Zjarret e hapura

Para së gjithash është e rëndësishme të gjeni një vend të përshtatshëm për të ndezur një zjarr. Shpeshherë mund të gjeni zjarre jashtë në arkipelag dhe përgjatë rrugëve për këmbësorë.

Nëse nuk ka vatra zjarri në natyrë, atëherë gjeni një vend të qetë dhe të mbrojtur, sa më pranë ujit që të jetë e mundur. Hapni një gropë ose vendosni gurë rreth e përqark vatrës dhe mbajeni zjarrin të vogël. Ndezja e zjarrit direkt në gur është e ndaluar.

Nëse është kohë me erë, atëherë shkëndijat mund të shpërndahen. Sigurohuni që shkëndijat të mos fryjnë në drejtim të tokës ose pyllit. Shuajeni zjarrin mirë para se të largoheni dhe siguroheni që lejohet ndezja e zjarrit. Ndezja e zjarreve është e ndaluar gjatë parashikimit 5 të rrezikshmërisë ndaj zjarrit.

Nëse zjarri fillon të përhapet

Telefononi shërbimet e shpëtimit në numrin 112. Mundohuni ta ndaloni zjarrin që të mos të përhapet në drejtim të erës. Përdorni degë nga pemë bredhi ose dëllinje me thuprat që kanë mbetur vetëm në krye, 1 metër. Njomini degët nëse është e mundur. Mos i bini zjarrit me shumë forcë, sepse kjo bën që shkëndijat të fluturojnë dhe zjarri të fitojë shpejtësi. Mblidhni të gjitha materialet djegëse në drejtim të zjarrit, duke e shtyrë degën në tokë, sikur të jeni duke e mbuluar zjarrin. Hidhni thuprat anash dhe hiqini myshqet para zjarrit.

Kur të gatuani jashtë

- Mos piqui asnjëherë mishra në skarë ose të ndizni një zjarr të hapur në një tendë ose në një tendë karvani. Tenda merr zjarr shumë shpejt, kështu që shtyllat flakëruese si dhe drutë e zjarrit lëshojnë monoksid karboni me lëndë toksike.
- Vendoseni skarën e pjekjes në një sipërfaqe të sheshtë dhe të padjegëshme, të paktën një metër larg tendës ose karvanit.
- Mbajeni lëngun për ndezjen e zjarrit, të paktën 3 metra larg skarës.
- Mos e lini asnjëherë skarën të pashoqëruar.
- Vendoseni qymyrin e përdorur në vendin e caktuar. Lënda djegëse e përdorur nga pjekja në skarë me qymyr, mund ta mbajë nxehtësinë deri në 3 ditë.
- Mos hidhni asnjëherë lëndë djegëse në vatrën e sobës, derisa të jeni të bindur që vetë flaka është shuar dhe se vatra është ftohur – përndryshe lënda djegëse

në bombul mund të flakërojë dhe mund të shkaktojë plagë të rënda me djegie. Plagët e djegies duhet të ftohen me ujë për dhjetë minuta ose më tepër. Nëse zjarri ju bie në rroba, shtrihuni në tokë dhe rrotullohuni nga njëra anë në tjetrën derisa zjarri të jetë shuar.

TELEFONONI GJITHMONË 112 NË RASTE ZJARRI

Shoqata Suedeze për Mbrojtjen nga Zjarri është një organizatë anëtare, e cila punon për ta bërë Suedinë një vend më të sigurtë. Me anë të informatave dhe trajnimeve, ne i ndihmojmë njerëzit, kompanitë dhe organizatat që të jenë përgjegjëse për parandalimin e zjarrit. 08-588 474 00. www.brandskyddsforeningen.se